



# ESG

## RAPORTI VJETOR 2023





## HERJOLA SPAHIU

Drejtor i Përgjithshëm  
Ekzekutiv

Në rrugëtimin tonë profesional, si Drejtorë të Përgjithshëm Ekzekutivë, jemi shumë të interesuar për performancën e kompanive që drejtojmë, duke u kujdesur për t'i motivuar si duhet ekipet tona, për të krijuar vlerë financiare për aksionerët, por më e rëndësishmja, për të krijuar përvojën më të mirë për klientët tanë. Dhe më besoni, është jashtëzakonisht e vështirë dhe një përgjegjësi shumë e madhe që duhet të mbajmë çdo ditë mbi supe, veçanërisht në një ekonomi të paqëndrueshme që karakterizohet nga ndryshime të papritura të tregut...

E nëse kjo është mjaft e vështirë në kohët e sotme, sa sfiduese duhet të jetë të krijosh vlerë për të ardhmen, ku përgjatë asaj çfarë ne bëjmë në përditshmëri duhet të kujdesemi të krijojmë vlerë dhe impakt pozitiv për brezat që do të vijnë, për nipërit tanë, për punonjësit, klientët dhe palët e tjera të interesuara në të ardhmen.

Secili prej nesh individualisht, në ekipet dhe familjet tona duhet të fillojë të kuptojë rolin tonë të rëndësishëm sot e në vazhdim, drejt një ekonomie të qëndrueshme ku përfitimet sociale dhe mjedisore mund të jenë një mbështetje e fortë e kthimeve financiare, ku impakti pozitiv për një komunitet të caktuar mund të jetë më i rëndësishëm se sa vetë prodhimi për një kompani, ku politikatat e riciklimit dhe ekonomisë së gjelbër mund të mbrojnë të ardhmen e burimeve të kufizuara të Tokës.



*"Ky raport pioner i ESG, është pasqyra më e mirë e vlerave tona në kuadër të 25 vjetorit të aktivitetit."*

## MANJOLA ÇERENISHTI

Drejtore e Departamentit të  
ESG & Komunikimit të Brandit

Promovimi i një #FinanceNjerëzore për NOA shkon përtej të qenurit thjesht një slogan. Është një angazhim ku individ është prioriteti ynë, po ashtu familja, komuniteti ku ai jeton, trashëgimia dhe rrënjët mbi të cilat ai ndërton të ardhmen e familjes së tij. Ndaj ky slogan unik i NOA-s, përkthehet në realitet në një detyrim tonin për të mbështetur çdokënd që përfiton nga financimet tona brenda një kuadri gjithëpërfshirës e të përgjegjshëm që bazohet mbi vlerat më të larta njerëzore.

#FinancëNjerëzore nënkupton mbrojtjen e klientit, por dhe të stafit tonë. Mbrojtjen e mjedisit profesional dhe natyrës që na rrethon çdo ditë, duke lejuar cilindo prej nesh të rritet në mënyrë të shëndetshme, për një mirëqenie fizike të trupit dhe mendjes. Mbrojtjen e praktikave më të mira në të bërit biznes, në rrafshin e transparencës, e standardeve ligjore e korporative. Një sërë angazhimesh që shkojnë në një linjë me përkufizimin e normave të ESG (mjedis, social, qeverisje) për të cilat NOA po investon fort për t'i përdorur në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Ky raport pioner i ESG, në kuadër dhe të 25 vjetorit të aktivitetit tonë, është dëshmia më e madhe e këtij investimi institucional të NOA e të qenurit pararojë e inovacionit social e njëherazi lider i sektorit të financimit të sipërmarrjes shqiptare duke garantuar gjithmonë më të mirën dhe një akses cilësor në financa, për çdo target grup, komunitet e për çdo ambicie.

# MBI KËTË RAPORT

Faleminderit për interesin tuaj ndaj raportit të parë ESG të NOA. Jemi të lumtur që investimi ynë institucional ndër vite në promovimin e dimensionit social të aktivitetit tonë kredidhënës materializohet në një produkt raportimi si ky që po i paraqesim palëve të interesuara.

Në përgatitjen e këtij raporti kanë kontribuar të gjitha njësitë operacionale të NOA-s që merren me mbikqyrjen e aktivitetit tonë. Krijimi në vitin 2023 i një njësie të dedikuar ESG në nivel drejtues të lartë, është dëshmi e seriozitetit të investimit të NOA në drejtim të ESG. Ky raport, është fruti i parë i këtij ndërveprimi të ri organizativ brenda kompanisë. Duke qenë se për kuadrin ESG nuk ka ende një përcaktim të unifikuar të zbatueshëm për sektorin mikrofinanciar, NOA është mbështetur në praktikat më të mira aktuale duke miratuar në nivel të Këshillit Mbikqyrës, si organi më i lartë i vendimarrjes në kompani, një udhërrëfyes të detajuar mbi objektivat dhe indikatorët ESG të cituar në këtë raport.



Nëse dëshironi më shumë informacion mbi aktivitetin financiar të NOA, apo zhvillimet më të fundit, ju ftojmë të vizitoni faqen tonë web [www.noafin.al](http://www.noafin.al)



# STRATEGJIA JONË

Realizimi i këtij raporti të parë ESG për NOA-n përfaqëson një ushtrim institucional unik. Pjesë e udhërrëfyesit tashmë të miratuar në nivel të Këshillit Mbikqyrës të NOA, raporti bazohet mbi indikatorë konkretë, procedura, standarde referencë e plane pune konkrete të cilat ndërthuren në kuadrin e një strategjie të përqëndruar. Ky kuadër zbatohet në një shtrirje të dyfishtë, vertikale dhe horizontale.

Shtrirja e parë nënkupton mbulimin nga kuadri ESG i çdo niveli të kompanisë, nga niveli ekzekutiv e deri tek punonjësit e klientët fundorë. Shtrirja e dytë nënkupton mbulimin e çdo departamenti, çdo dege e çdo territori ku NOA shtrin aktivitetin e saj.


Udhërrëfyesi ESG ka tre dimensione kryesore. I pari përmbledh vlerat dhe objektivat që i aplikohen nivelit korporativ të kompanisë, duke u siguruar që vizioni ESG të ketë një përjasje realisht të pranuar në nivel administrativ e menaxherial. I dyti shtrihet në nivel të aktivitetit të kompanisë duke mbuluar çështjet që prekin impaktin e kredidhënies, produktet, etj. Ndërkohë që niveli i tretë dhe i fundit mbulon aspektet operacionale të të përditshmes institucionale duke u siguruar që kompania, si një organizatë, të respektojë standardet më të larta të aplikueshme.



# ANËTARË TË KËSHILLIT MBIKQYRËS

## 57 vjeç

MOSHA MESATARE  
E ANËTARËVE TË KËSHILLIT  
MBIKQYRËS



Këshilli Mbikqyrës i NOA ka miratuar në Maj 2023 një dokument strategjik mbi promovimin e standardeve ESG – Mjedis, Social, Qeverisje Korporative. Të përfshira në një udhërrëfyes që detajon objektivat dhe indikatorët matës respektivë, strategjia ESG e NOA synon të minimizojë maksimalisht efektet e padëshiruara që mund të rezultojnë nga aktiviteti i NOA, si në rrafshin komercial ashtu dhe në atë institucional.

Përveç kësaj, Këshilli Mbikqyrës miratoi objektivat jo-financiare për Drejtuesit Ekzekutivë të Institucionit. Miratimi në nivel bordi të këtij dokumenti është dëshmi e seriozitetit të investimit të NOA në këtë drejtim.



# MISIONI DHE ROLI I KËSHILLIT MBIKQYRËS TË NOA-S NË KUADËR TË ESG

Si një institucion financiar i përgjegjshëm, NOA beson se integrimi i objektivave mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) janë thelbësorë në garantimin e një performance afatgjatë të qëndrueshme, jo vetëm për institucionin, stafin e klientët, por mbi të gjitha për shoqërinë në tërësi. Në këtë kontekst, Këshilli Mbikqyrës i NOA, sipas parashikimeve të udhërrëfyesit ESG ka një rol kyç në përcaktimin, monitorimin dhe promovimin e politikës ESG.

Këshilli Mbikqyrës i NOA në këtë drejtim merr përsipër:

- Përcaktimin e politikës ESG dhe integrimin e saj në strategjinë afatgjatë të kompanisë, duke përcaktuar objektivat kryesorë ESG si elementë udhëzues për të gjithë ekipin drejtues dhe stafin e kompanisë.
- Monitorimin e performancës dhe të nismave ESG duke mbikqyrur dhe kërkuar raportimin adekuat në terma të impaktit mjedisor, social dhe të qeverisjes së kompanisë, si dhe duke garantuar transparencën e nevojshme në raportimin e të dhënave ESG ndaj palëve të interesuara.
- Ndërtimi i një kulture ESG duke u siguruar që kompania mbetet e përkushtuar ndaj vlerave ESG në të gjitha nivelet e saj, falë promovimit të një kulture dialogu, gjithëpërfshirjeje dhe përgjegjshmërie si pjesë e identitetit të kompanisë.
- Vendosjen dhe monitorimin e objektivave jo-financiare për Drejtuesit Ekzekutivë të Institucionit.

Besnikë ndaj vlerave themeluese të NOA, Këshilli Mbikqyrës e njeh rëndësinë e politikës ESG dhe angazhohet në arritjen e objektivave të institucionit në mbështetje të komuniteteve të shërbyera, në planin financiar dhe jo-financiar. Përmes hallkave dhe objektivave të përcaktuar në udhërrëfyesin ESG, Këshilli Mbikqyrës është një vektor real promovimi dhe ndryshimi i cili kërkon të promovojë praktikatat më të mira sektoriale ndërkombëtare.

# ESG, KONKRETISHT...

Strategjia ESG e NOA mbulon çdo aspekt të impaktit të aktivitetit të NOA.

Në nivel të drejtimit të kompanisë, në nivel të produkteve financiare, dhe në nivel të menaxhimit në të përditshmen, NOA aplikon në çdo shtresëzim të institucionit kriteret e qarta mbi barazinë gjinore; mbrojtjen e klientit, të komuniteteve dhe të mjedisit; transparencën në punësim, në financime dhe në promovimin në karrierë; raportimin mbi aktivitetin financiar, mbi burimet njerëzore e impaktin socioekonomik etj.

Si pjesë e aksionit ESG të NOA dhe në kuadër të Qëllimeve për një Zhvillim të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, NOA angazhohet në promovimin e katër qëllimeve, të cilat janë përfshirë plotësisht në strategjitë e saj të brendshme: Jo më varfëri; Barazi gjinore; Punësim dinjitoz dhe rritje ekonomike; Industri, inovacion dhe infrastrukturë. Një angazhim që u certifikua dhe nga UNDP duke përzgjedhur NOA si një ndër tre finalistët e konkursit SDG të zhvilluar më 2023.

**10** BLOQE ESG **87** ANGAZHIME

**113** OBJEKTIVA ESG TË REALIZUARA

## ANGAZHIMET E NOA NË MBËSHTETJE TË QËLLIMEVE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM – OKB





# NOA, FINALISTE E "SDG BUSINESS PIONEER AWARD"

Si pjesë e angazhimeve ESG, NOA është një institucion i cili përqafton objektivat e vendosura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në shërbim të një zhvillimi socio-ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë drejtim, vlerësimi i NOA në 2023 si një ndër tre institucionet finaliste të konkursit organizuar nga **UNDP "SGD Business Pioneer Award"**, ishte një konfirmim i mirëpritur i investimit të institucionit.


Finaliste krahas Bankës Credins dhe Grupit Balfin, ky konkurs konfirmon pozicionimin e NOA si një ndër institucionet financiare lider në vend në promovimin e standardeve më të larta mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative.

Renditja si një ndër tre finalistët erdhi pas një procesi vlerësimi e raportimi sipas kriterëve të kërkuara nga ekipi organizues i nismës. Transparenca institucionale për NOA-n nënkupton edhe disponueshmërinë e raportimit në konkurse të tilla.



SDG Business  
Pioneers Award  
in Albania

# FJALOR ESG – NOA



## • **Transparencë**

NOA respekton çdo detyrim dhe standard të sektorit mbi publikimin e të dhënave financiare të institucionit, kostot dhe termat ligjore e financiare të produkteve të ofruara ndaj klientëve, ofertat e punësimit dhe oportunitetet për promovim, ashtu si dhe publikimin e çdo materiali që i shërben një informimi sa më të drejtë nga çdo audiencë me të cilën NOA ndërvepron.

## • **Gjithëpërfshirje**

Në drejtim të klientëve apo të punonjësve, NOA është një institucion jo-diskriminues, që mbulon me produktet e saj çdo vendodhje, shtresë sociale apo kategori socio-profesionale, ashtu siç kujdeset që çdo nivel i brendshëm të jetë pasqyrues i drejtë i shoqërisë shqiptare duke promovuar çdo individ ekskluzivisht në bazë të aftësisve personale dhe jo kriteresh informale.

## • **Respekt**

Klienti, mjedisi, komuniteti e punonjësit, në NOA 'respekti' nënkupton një angazhim total në drejtim të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor dhe të trashëgimisë natyrore e sociale, sipas parimeve të një finance njerëzore të bazuar në procedura e kritere të formalizuara.

## • **Matje**

Përtej angazhimeve institucionale, NOA mat impaktin e aktivitetit të saj duke vendosur një indikator numerik për çdo element që prek strategjinë e saj ESG në mënyrë që zhvillimi i përvitshëm të jetë i kuantifikuar, realist dhe ambicioz.

## • **Ligjshmëri**

Çdo produkt financiar ashtu si dhe çdo bashkëpunim institucional i NOA mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë duke u garantuar gjithmonë që dhe klientët apo partnerët tanë institucionalë të mbeten brenda kësaj kornize ligjore në kuadër të bashkëpunimit me NOA.

## • **Përgjegjshmëri**

Në nivel të bordit drejtues, apo të punonjësit më të ri, NOA promovon praktikat e mira duke evidentuar çdo aksion i cili nxit përgjegjshmërinë institucionale në drejtim të respektimit të normave ESG.

## • **Angazhim**

NOA ka një strategji të dedikuar ESG si një dëshmi e një kuadri të plotë normash të cilat ndiqen nga niveli më i lartë i kompanisë dhe deri tek punonjësi më i ri si një angazhim real, i prekshëm dhe i matshëm në çdo segment të kompanisë.

## • **Mbrojtje**

Të dhënat e klientit, të burimeve natyrore, të buxhetit familjar, të vendeve të punës e të një zhvillimi të qëndrueshëm, 'mbrojtja' për NOA është garantimi se askush nuk dëmtohet nga aktiviteti i NOA, as në nivel mbi-kreditimi, as në nivel rrjedhjesh të dhënash apo eksternalitetesh mjedisore.

## • **Mbështetje**

Aktive prej 25 vitesh në tregun shqiptar, NOA financon nisma sociale, aksione trajnimi, fushata sensibilizimi, promovime biznesi e mjedisore etj. si një mënyrë për të mbështetur vlerat ESG që janë faktikisht në themel të vetë krijimit.

# ESG, NJË RISI NË NOA

Prej muajit Janar të vitit 2023, struktura organizative e NOA është pasuruar duke përfshirë tanimë një Drejtor departamenti të dedikuar për promovimin e standardeve ESG sipas strategjisë së miratuar në nivel bordi. Drejtori i departamentit ESG raporton në bordin e NOA mbi ecurinë e strategjisë. Standardet ESG janë përfshirë prej 2023 në trajnimin e detyrueshëm për çdo staf të ri që i bashkohet NOA.

Gjatë vitit 2023 e në vijim, NOA ka organizuar një tur nëpër degët e saj me qëllim fillimin e sensibilizimit të të gjithë rrjetit mbi standardet ESG. Krahas këtyre takimeve, NOA ka nxjerrë dhe artikuj të shpeshtë me fokus ESG në buletinin e brendshëm të kompanisë, duke siguruar një dialog sa më të konsoliduar mes niveleve të ndryshme të kompanisë, duke promovuar transparencën dhe nismat madhore të kompanisë.

Për të dytën herë rradhazi, NOA mirëpriti në qershor të vitit 2023 një ekip studentësh francezë nga shkolla e biznesit EM Lyon. Ardhja e tyre është në kuadër të bashkëpunimit me NOISE, një shoqatë e specializuar në mikrofinancë. Gjatë misionit të tyre një muhor në Shqipëri, ekipi i NOISE u angazhua në hulumtimin dhe pasurimin e planit të aksionit ESG të NOA sipas standardeve më të mira të sektorit mikrofinanciar Europian.



# NJË ANGAZHIM SIPAS STANDARDEVE MË TË LARTA TË TREGUT

Me qëllim përthithjen e praktikave më të mira të tregut, NOA është aktive në disa institucione sektoriale dhe njëherazi e certifikuar sipas disa normave korporative ndërkombëtare të cilat garantojnë standardet më të larta të raportimit korporativ, të menaxhimit të riskut dhe të aseteve, të politikave të burimeve njerëzore etj.



#FinancëNjerëzore për NOA është një angazhim institucional në ofrimin e standardeve më të larta për çdo klient përfitues, pavarësisht lokacionit, moshës apo formimit profesional. Certifikimi i NOA-s gjatë vitit 2023 nga agjencia ndërkombëtare MFR si konform standardeve të **"CPC – Client Protection Certificate"** (Certifikatë e Mbrojtjes së Klientëve) është dëshmia më e lartë e investimit të NOA-s në drejtim të mbrojtjes së klientëve të saj nga mbi-kreditimi, të transparencës së produkteve të ofruara, të mbrojtjes së të dhënave personale të klientëve etj.



# MBI TË GJITHA, ESG DO TË THOTË CILËSI SHËRBIMI

NOA angazhohet të respektojë vlerat e një institucioni financiar i cili bazohet mbi modelin e një #FinanceNjerëzore. Një koncept që shkon përtej avantazheve konkurrionale e sociale dhe që përfshin dhe garantimin e mundësisë për çdo përfitues të financimeve të NOA për të denoncuar çdo praktikë abuzive, shkelje të termave kontraktuale, sjellje jo-etike apo jo-profesionale. Kjo nënkupton ndërtimin e mekanizmave dhe procedurave të mirëfillta e të mirë-përcaktuara, konform standardeve më të mira të sektorit financiar.

Koha mesatare e adresimit të këtyre ankesave është 7.6 ditë, një rritje e lehtë nga 7.5 ditë në vitin 2022. Theksojmë se NOA u certifikua në vitin 2023 sipas standardit më të lartë European të mbrojtjes së klientit CPC.


**78**  
ANKESA

**7.6**  
DITË MESATARE  
ADRESIMI




# IMPAKTI SOCIO-EKONOMIK I AKTIVITETIT FINANCIAR TË NOA

Prej 25 vitesh, NOA konsiderohet si lider i financimit të biznesit të vogël dhe fermerit shqiptar duke arritur në fund të vitit 2023 një shifër prej 66.4 milion euro portofol financimi aktiv për këto dy segmente që përmbledhin 6.541 të vetëpunësuar, pronarë biznesesh e sipërmarrjesh të vogla si dhe fermerë të shtrirë anembanë vendit në zona rurale e urbane. Për bujqësinë në veçanti, portofili aktiv ka arritur në 16.58 milion euro me një ndryshim nga +21% nga viti i kaluar. Ndërkohë për biznesin, portofoli i kredisë është rritur gjatë 2023 gjithashtu me +20% duke arritur vlerën e 49.8 milion eurove.



Si një institucion që operon konform “Kodit të Praktikave të Mira të Mikrofinancës” të Komisionit European i cili imponon dhe një nivel transparence korporative të lartë, në Janar 2023 NOA u ratua në rrafshin e aktivitetit financiar e menaxherial nga agjencia ndërkombëtare MFR me vlerësimin “**a- e lartë**”. Ky ratim e vendos perspektivën institucionale të NOA-s në nivelet më të larta duke konfirmuar dhe bazat e shëndosha mbi të cilat u arrit rritja e portofolit të financimit gjatë vitit 2023 me 25%.

Besnike ndaj misionit të saj social për të garantuar një akses të përhershëm në financë për çdo komunitet të diskriminuar për shkak të pozitive gjeografike apo sociale, NOA është një institucion financiar i cili investohet në monitorimin e impaktit që financimet e saj kanë në shoqëri. Kështu, gjatë vitit 2023, mbi 35% e klientëve të saj ishin gra, 17% ruralë, dhe 76% e totalit të disbursimeve u kryen nga degët e rretheve.



# PËR NJË KREDIDHËNIE TË PËRGJEGJSHME DHE TË QËNDRUESHME



Këshillimi është një nga tre kolonat e shërbimit të ofruar nga NOA krahas financimit dhe partneriteteve. Një risi e viteve të fundit, në vitin 2023 NOA promovoi 35 këshillime agro & 14 këshillime biznesi të cilat shpërndahen falas dhe në një mënyrë digjitale drejt klientëve të NOA.

Në vitin 2023 janë 20 aplikime të cilat janë refuzuar për arsye mos-respektimi të normave të brendshme të NOA. Dhe pse NOA ofron një fleksibilitet të lartë në produktet financiare të saj, kjo vjen me një politikë strikte përjashtuese ndaj një seri aktiviteteve që konsiderohen të dëmshme për natyrën, për trashëgiminë kulturore etj. Është pikërisht kjo qasje sociale e përgjegjshme që bën që çdo vit të refuzohen në mënyrë kategorike aplikimet për financim që nuk respektojnë këto norma.

STANDARDET  
**ESG**





Një ndër akset e reja prioritare në NOA, financimi ekskluzivisht për efencën energjetike në vitin 2023 ka arritur nivelin e 225 mijë eurove.

Një shifër kjo relativisht e ulët por që kompensohet nga fakti se financimi i NOA-s për investime në asete fikse biznesi e bujqësore në 2023 kapi vlerën e 26.3 milion eurove (portofol aktiv), ku shpesh herë, investimi përmban një seri zërash ku përfshihen dhe punime në termoizolimim e mjediseve të biznesit, instalimin e paneleve etj.



Si pjesë e këtij angazhimi, NOA ka promovuar fushatën **"Kreditim i Zgjuar"** 2023 drejt klientëve dhe audiencës së saj si pjesë e MFC, si një mjet efektiv për t'u njohur me dimensionin social të sektorit mikrofinanciar në vend. Fushata Kreditim i Zgjuar ka një dimension të rëndësishëm në Shqipëri, sepse krijon një lidhje midis vendit dhe ambicieve të tij për integrim europian. Komunikimi i NOA-s për fushatën Kreditim i Zgjuar ka ndjekur një qasje përmes kanaleve digjitale, takimeve fizike/online dhe artikujve këshillues.



# PROMOVIMI I KOMUNITETEVE DHE TË NJË ZHVILLIMI EKONOMIK QË RESPEKTON TRADITËN

Viti 2023 numëron 16 aktivitete në drejtim të biznesit si një dëshmi e rëndësisë që NOA i jep kontaktit të përditshëm me realitetet e tregut dhe të bizneseve shqiptare. Organizimi i seminareve trajnuese, pjesëmarrje në panaire biznesi, promovimi i forumeve ekonomike etj., NOA investohet fuqimisht në përhapjen e një kulture dialogu, shkëmbimesh e rritjesh kapacitetesh për bizneset shqiptare si elementë kritikë e shoqërues për çdo financim që injekton në ekonominë shqiptare.



# PËRTEJ FINANCËS, MBËSHTETJE SOCIALE

Ekipe të NOA organizuan 12 aktivitete me karakter social gjatë vitit 2023. Nisma si ajo e EIPASS për muajin e autizmit; bashkëpunimi me Down Syndrome Albania (DSA); dhurimi gjakut në bashkëpunim me Red Cross Albania; dhurime librash, ushqimesh e veshjesh apo mbështetje të kauzës së fëmijëve; mbjellje pemësh etj.; mbështetja e kauzave sociale nga NOA merr forma të ndryshme si një pasqyrë e shumëllojshmërisë së komuniteteve me të cilat ndërveprojnë stafet e NOA në të përditshmen e tyre.



# BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE NË SHËRBIM TË ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK

Është një program shkëmbimi ndërkufitar i cili u jep sipërmarrësve të rinj dhe aspirues përfshirë edhe ata që kanë një ide novatore biznesi (NE- New Entrepreneurs – Sipërmarrësit e Rinj) mundësinë për të mësuar nga sipërmarrës me eksperiencë (HE- Host Entrepreneurs – Sipërmarrës me eksperiencë (Pritës)) dhe që drejtojnë biznese në vendet e tjera pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian dhe më gjerë.

- Në këtë program janë të përfshira 45 shtete nga Europa dhe më gjerë.
- Një Partneritet i përbërë nga 10 partnerë dhe 9 shtete të ndryshme si: Italia, Spanja, Bullgaria, Armenia, Letonia, Lituania, Holanda, Franca, Shqipëria dhe Turqia
- Do të mbështesë shkëmbimin e 40 sipërmarrësve, nga të cilët 20 sipërmarrës të rinj (NE) (përfshirë edhe start-up-e) dhe 20 Sipërmarrësit Pritës (HE)
- Periudha e shkëmbimit dhe qëndrimit në vendin në të cilin bëhet shkëmbimi përcaktohet në një afat nga 1-6 muaj
- Nuk ka asnjë kufizim sektorial, pra janë të përfshirë të gjithë sektorët
- Periudha e zbatimit të projektit 4 vite (01 Shkurt 2023 – 31 Janar 2027)

Ky projekt mbështetet dhe financohet nga Bashkimi Evropian.

Erasmus for Young  
Entrepreneurs



Funded by  
the European Union



Si një institucion themeluar nga USAID 25 vite më parë, rifillimi i bashkëpunimit mes NOA dhe USAID gjatë vitit 2023 në kuadër të nismës FALP (financimi i sektorit tekstil e lëkurë) përmbante një simbolikë jo vetëm institucionale por dhe sektoriale duke i mundësuar NOA-s të promovonte për herë të parë një produkt financiar të dedikuar vetëm për sektorin fason dhe rritjes së kapaciteteve të një numri kompanish lider në punësimin e grave në Shqipëri. Përpos financimit, nisma ofron dhe trajnime e suport për kompanitë përfituese duke u siguruar për një investim sa më të mirëmenduar.

Në kuadër të këtij projekti deri në fund të muajit Dhjetor 2023:

- janë financuar 29 SME
- me një volum prej rreth 1.5 milion USD
- janë trajnuar 47 SME
- me një numër stafi total prej 570 punonjës



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE




# KUJDESEMI PËR MJEDISIN

NOA investohet të ulë sa më shumë impaktin në mjedis duke futur praktika të reja eko-inteligjente të cilat reduktojnë si shembull numrin e printimeve nëpërmjet përdorimi të firmës elektronike për çdo dokument të brendshëm, ulja e përdorimit të kartvizita të printuara dhe përdorimi i email signature, përdorimi i kodit për printimet dhe sensibilizimin e përdoruesëve që të mos printohet asgjë nëse nuk është vërtetë e nevojshme, fikje automatike të pajisjeve elektronike duke ulur kostot e energjisë etj. Këto praktika kanë bërë që gjatë vitit 2023, totali i printimeve të jetë ulur me 20% krahasuar me një vit më parë.



Dokumenta të nënshkruara elektronikisht



Vendosja e firmës elektronike në funksionimin e brendshëm të NOA është një hap i cili nxit kulturën digjitale në mënyrën e trajtimit të dokumentave të brendshëm (ulje e hapësirës për arkivim, konfirmim i përshpejtuar, komunikim mes çdo ekipi, mos-printim por duke rritur transparencën etj.) por gjithashtu hedh gurthemelet e nevojshme për një marrëdhënie kontraktuale tërësisht digjitale edhe me klientët. Në tërësi, viti 2023 arriti një rekord të firmave dokumentave të konfirmuar në mënyrë digjitale çka ka patur dhe një impakt në gjurmën mjedisore të NOA.

■ 2022 ■ 2023 ■ 2024

1,016 lb of carbon emissions reduces



1,274 gal of water conserved



432 lb of wood saved



70 lb of wasted eliminated



# NË ZEMËR TË ESG, NJERËZIT

Në vitin 2021, NOA solli një benefit të ri shtesë për punonjësit e saj, Fondin e Pensionit Vullnetar, një benefit shumë i rëndësishëm, i cili synon rritjen e mirëqënies së stafit në moshën e pensionit. Përgjatë tri viteve NOA ka 3-fishuar kontributin e saj ndaj punonjësve, gjë që ka ndikuar në rritjen e numrit të pjesëmarrjes në fond me 70%.

NOA është mikrofinanca e parë që ka aplikuar orarin e reduktuar të punës për ditën e premte, gjatë muajve të verës 2023, iniciativë e cila synon do të vazhdojë përgjatë gjithë vitit. Kjo iniciativë vjen në kuadër të nismave tona incentivuese për punonjësit bazuar në praktikat më të mira të punës si dhe për të mbështetur mirëqenien dhe balancën jetë-punë të punonjësve si çelësin e suksesit tonë.

Në 2023, NOA lançoi programin e "Besnikërisë në Punë". Përgjatë rrugëtimit tonë 25 vjeçar shumë punonjës të rinj na janë bashkuar, por ne kemi arritur të rrënjosisim dhe përcjellim vlerat tona më të forta nëpërmjet atyre që i kanë qëndruar besnikë institucionit ndër vite dhe e kanë pasuruar këtë rrugëtim me dedikim të pakursyer dhe energji të pashteruar duke e shndërruar NOA-n në një familje të madhe. Ndaj ne vendosëm të festojmë besnikërinë e tyre ndaj institucionit, në një event të dedikuar mirënjohjes, i pari i këtij lloji për ta vijuar me të tjera nisma gjatë vitit.




BESNIKË NË PUNË



ORAR I REDUKTUAR TË PREMTEN


# TË DHËNAT E DIVERSITETIT TË STAFIT NË NOA



Staf

● Gra

● Meshkuj



Lidership Senior

● Gra

● Meshkuj

**22**

Module trajnimi

**250**

Pjesëmarrës në trajnime

**900**

Orë trajnime

**19**

Promovime të brendshme, nga të cilat 7 në pozicione drejtuese

**10%**

Të punësimeve nga internshipet

NOA është mikrofinanca e parë që ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Dioqezan Tiranë–Durrës në kuadër të projektit "Your Job". NOA mbështet aktivisht komunitetin dhe veçanërisht punësimin e të rinjve, duke ju krijuar mundësi për një karrierë të suksesshme dhe zhvillim personal dhe profesional. Prej 7 muajsh Redona i është bashkuar skuadrës tonë në NOA falë këtij bashkëpunimi.

Regional Challenge Fund for Western Balkans NOA nënshkroi një marrëveshje partneriteti në kuadër të RCF me Universitetin Metropolitan të Tiranës, me qëllim ofrimin e programeve zhvillimore profesionale/trajnuese të cilat ofrohen nga institucione edukimi dhe kompani në Ballkanin Perëndimor. Ky është një projekt që mbështetet nga institucione gjermane të zhvillimit, përfshirë GIZ dhe ka të bëjë me edukimin në fushën e Digital Finance. NOA në bashkëpunim me Universitetin do të bashkë-dizenjojë një program 9 mujor trajnimi, përfshirë kurrikula, trajnim dhe internship për studentët në nivel bachelor. Studentët që do të jenë të suksesshëm mund të përzgjidhen për punësim nga NOA.

NOA në mbështetje të të rinjve dhe edukimit e zhvillimit të tyre tregojn kujdes të veçantë duke marrë pjesë aktivisht në aktivitete/panaie/bashkëpunime të cilat kanë qëllim informimin, zhvillimin e të rinjve, nxitjen e punësimit, zbulimin e talenteve dhe orientimin e tyre drejt një karriere të suksesshme. Falë këtyre bashkëpunimeve në vitin 2023, 10% e punësimeve në institucion kanë ardhur nga internshipet/praktikat mësimore.





